**LIGJ**

**PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER MATERIAL ARKIVOR**

Neni 1

Ne Ligjin per materialarkivor (“Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise” numer 95/12), pas nenit 1 shtohet nen i ri 1-a, si vijon:

“Neni 1-a

Me ArkivinShteteror udheheq drejtori.

Drejtorine Arkivit Shteteror e emeron dhe shkarkon Qeveriae Republikes se Maqedonise.

Per emerim te drejtorit shpallet konkurs publik se paku ne tregazeta ditore te cilat botohen ne gjithe territorin e Republikesse Maqedonise, prej tecilave ne nje gazeteqe botohet ne gjuhen qe e flasin se paku 20% e qytetareve te cilet flasingjuhen zyrtare qe eshte ndryshenga gjuha maqedonase.

Drejtor mund te emerohet personii cili i ploteson keto kushte:

1) eshte shtetas i Republikes se Maqedonise;

2) ne momentin e emerimit me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesornuk i eshte kumtuar denim ose sanksionper kundervajtje per kryerje te profesionit, veprimtarise ose detyres;

3) ka fituar se paku 240 kredi sipas SETK ose ka mbaruarshkallen VII/1;

4) ka minimum pese vite pervojepune ne punet administrative;

5) posedon nje prej certifikatave ne vijim te njohura ne nivel nderkombetar ose vertetime per njohje aktive te gjuhesangleze jo me te vjeterse pese vite:

-TOEFL IBT se paku 74 pike,

-IELLTS (IELTS) – se paku 6 pike,

-ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) – minimum nivelinB2 (B2),

-FCE (FCE) (Cambridge English: First) – te kaluar;

-BULATS (BULATS) – se paku 60 pike ose

-APTIS (APTIS) - se paku niveli B2 (B2) dhe

6) ta kete dhenetestin psikologjik dhe testin per integritet.”